

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

BULETINI M U J O R I

MARS 2026



▶ Shëndetësia 2030, Ministrja Sala: Prioritet transformimi i onkologjisë, reforma spitalore dhe digjitalizim

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala gjatë bashkëbisedimit me gazetarët prezantoi prioritetet për vitin 2026 për onkologji moderne, sistem spitalor racional, shëndetësi digjitale dhe mirëqenie sociale që fuqizon qytetarët. Ministrja theksoi risitë kryesore, si ngritja e Shërbimit të Trombektomisë dhe fuqizimin e Shërbimit Onkologjik me pajisjen e re të Brankiterapi-së, Pet scan, 6 punkte rajonale për shërbimin e kimioterapisë ditore dhe për herë të parë do të kemi Qendrën e Gjirit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË
DHE MIRËQENIES



► “Barazia Gjinore” në OKB, Shqipëria prezanton arritjet dhe sfidat në fuqizimin e grave

Shqipëria rikonfirmoi angazhimin e saj për forcimin e aksesit të grave, gjatë aktiviteteve në kuadër të Sesionit të 70-të Komisionit për Statusin e Grave në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në New York.

Në prezantimin e saj ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies, prof. Evis Sala theksoi përpjekjet e vazhdueshme të Shqipërisë për të avancuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e rolit të grave dhe vajzave në shoqëri përmes reformës në drejtësi, forcimit të legjislacionit dhe rritjes së përfaqësimit të grave në vendimmarrje.



▶ Ligji i ri për Aksesueshmërinë dhe Plani Kombëtar 2026–2030 për PAK, sipas standardeve të BE

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, zhvilloi një takim me anëtarët e Këshillit Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuar, ku në fokus të diskutimeve ishin Ligji i ri për Aksesueshmërinë dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2026–2030. Ministrja Sala theksoi se këto dy dokumente kyçe, të harmonizuara me standardet e BE-së janë një angazhim politik për integrimin dhe përmirësimin e jetesës së personave me aftësi të kufizuara dhe synojnë garantimin e barazisë reale në akses ndaj shërbimeve, infrastrukturës, teknologjisë, përfshirjes në arsim, punësim, drejtësi dhe vendimmarrje politike.



► Reforma farmaceutike, ministrja Sala: Garanci për barna të sigurta dhe të përballueshme

Shqipëria dhe Italia do të bashkëpunojnë për përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e farmaceutikës, drejt përafrimit të mëtejshëm të sistemit farmaceutik shqiptar me praktikën më të mirë evropiane. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala gjatë takimit me përfaqësues të Agjencisë Italiane të Barnave (AIFA), u ndal në hapat që po ndërmerren për përmirësimin e aksesit të qytetarëve në barna të sigurta, cilësore dhe efektive, në përputhje me standardet evropiane.



► 226 profesionistë të shkencave teknike mjekësore janë punësuar së fundmi përmes portalit “Infermierë për Shqipërinë”

226 profesionistë të shkencave mjekësore teknike janë punësuar gjatë procesit të fundit të përzgjedhjes së aplikimeve në portalin “Infermierë për Shqipërinë”, një proces i orientuar drejt meritokracisë, transparencës dhe barazisë së mundësive për të gjithë profesionistët e shëndetësisë.



► Miratohet VKM “Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave” dhe Plani i Veprimit për Garancinë Europiane të Fëmijëve

Këshilli i Ministrave miratoi VKM-në për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Çmimit të Barnave, duke synuar rritjen e transparencës dhe garantimin e çmimeve më të përballueshme për qytetarët. Po ashtu, u miratua edhe Plani Kombëtar i Veprimit për Garancinë Europiane të Fëmijëve 2026-2030, i fokusuar në përmirësimin e aksesit të fëmijëve, veçanërisht atyre në nevojë, në shërbime bazë si arsimi, shëndetësia dhe mirëqenia sociale.



▶ Ministria Sala dialog me të rinjtë: Angazhimi juaj është kyç për progresin e Shqipërisë drejt BE-së

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, zhvilloi një bashkëbisedim me studentë dhe pedagogë të Fakultetit të Shkencave Sociale, ku vlerësoi rolin e universiteteve si hapësira ku prodhohen ide, politika dhe modele të reja mendimi që ndikojnë drejtpërdrejt në transformimin e shoqërisë. Ajo ftoi studentët të angazhohen aktivisht përmes kërkimit, analizës dhe debatit publik për çështje të rëndësishme të zhvillimit shoqëror si barazia gjinore, përfshirja sociale dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, duke theksuar se kontributi i tyre është thelbësor integrimin e Shqipërisë drejt BE-së dhe ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.



▶ Së shpejti nis rikonstruksioni i Urgjencës në Spitalin Rajonal Durrës

Në Spitalin Rajonal Durrës, shumë shpejt do të nisë puna për rikonstruksionin e Urgjencës. Ky investim do të përfshijë ndërhyrjet si në infrastrukturë ashtu edhe në pajisje, duke përbërë një hap të domosdoshëm në përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor, uljen e kohës së pritjes dhe rritjen e barazisë dhe sigurisë për të gjithë pacientët. Ky transformim do të ndikojë pozitivisht edhe në përballimin dhe menaxhimin me efikasitet të fluksit të pacientëve gjatë sezonit turistik.



► Nis zbatimi i projekteve PRISMA dhe ANMA, pjesë e programit “MATHERNA”


Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane, ka nisur zbatimi i projekteve PRISMA dhe ANMA, pjesë e programit “MATHERNA”, i cili synon forcimin dhe modernizimin e shërbimeve neonatale dhe përmirësimin e kujdesit për nënën në Shqipëri. Gjatë takimeve dypalëshe të zhvilluara në Milano, Itali, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë institucionalë dhe ekipeve teknike nga të dy vendet, u dakordësuan hapat konkretë për fillimin e zbatimit të programit në strukturat spitalore universitare dhe rajonale.



► Teknologji inovative në Laboratorin e SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”

Laboratori i Qendrës së Diagnozës Molekulare, pranë Spitalit Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” është pajisur me teknologji të re dhe moderne, e cila mundëson aplikimin e një teknike inovative në studimin e genomës. Ky investim shënon një zhvillim të ri në diagnostimin mjekësor përmes teknikës së avancuar të analizës së genomit, kryerjes së analizave gjenetike sipas standardeve ndërkombëtare dhe sigurimin e diagnozave më të shpejta, më të sakta dhe më të sigurta për pacientët.





REPUBLIKA E SHqipëRISE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

BULETINI M U J O R I

MARS 2026